



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

Procesverbal 2-2026

I Mbajtur në takimin e II-të të rregullt të KK-së me datën 30.01.2026, në sallën e Kuvendit në ora 10:00 nën kryesimin e Kryesuesit të KK-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtarës për informim.

Fjalën Hyrëse – Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi;

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, drejtor/e, media dhe shoqëri civile, të nderuar dhe të respektuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës së Ferizajt. Po fillojmë me mbledhjen e II-të të rregullt të Kuvendit të Komunës së Ferizajt dhe për këtë mbledhje në bazë të materialit që e keni marr propozoj këtë rend dite:

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KK-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KK-së;
4. Propozim-Vendim për Miratimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit dhe Bashkëfinancimit në mes të Komunës së Ferizajt dhe Caritas Kosova;
5. Propozim-Vendim për Emërimin e Nënkryetarit të Komunës për Komunitete;
6. Propozim-Vendim për Miratimin e Planit të Punës së Kuvendit 2026;
7. Propozim-Vendim për plotësim ndryshimin e Vendimit për Themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa me Nr:01.Nr.10 i datës 30.12.2025;
8. Propozim-Vendim për plotësim ndryshimin e Vendimit për Themelimin e Komitetit për Komunitete me Nr:01.Nr.11 i datës 30.12.2025;
9. Pyetje dhe kërkesa dhe
10. Të ndryshme.

Kryesuesi pasi lexoi rendin e ditës theksoi se sa i përket pjesëmarrjes nuk kam ndonjë informacion për mungesë, sa i përket rendit të ditës pyeti nëse ka dikush ndonjë pikë apo diçka për të shtuar dhe pasi s'pati, pyeti rreth procesverbalit a ka diçka për të shtuar apo vërejtje dhe pasi spati e hodhi në votim dhe kaloi me 38 vota për.00.

Sa i përket pikës së 4-te ia kaloi fjalën Drejtorit Balton Dërguti, i cili pasi përshëndeti të pranishmit, theksoi se kjo pikë propozoj që kjo marrëveshje të shkoj në votim me disa propozime, e para që të votohet preambula ashtu si është përmirësuar dhe e dyta tek përqindja të mbeten vetëm vlera pasi del 99%, sa i përket projektit “you job” ky projekt zbatohet nga Viti 2022 financues është Caritas Austria, ajo çka vlen të theksohet është se në Vitin 2026 ky projekt ka zgjedhur vetëm Komunën e Ferizajt dhe Prizrenit për këtë marrëveshje për të vazhduar me këtë projekt.

Vlen të theksohet se nga Viti 22-25 dikun janë punësuar 58 të rinjë dhe me këtë marrëveshje besoj që nga kjo do të përfitojnë edhe të tjerë, sa i përket komponentëve i keni të gjitha specifikat në propozim.

Brahim Osmani pasi përshëndeti të pranishmit theksoi; që e para, ky propozim do të duhej të ishte ekskluzivisht kompetencë e kryetarit për ta nënshkru, pa e prurë këtu në kuvend, pra e para do të duhej të diskutohej marrëveshjet e Caritas-it së mandatit të kaluar e të cilat ky ekzekutiv asnjëherë nuk i ka përfunduar si duhet, e keni p.sh. kontratë me punëtorët në arsim, në shëndetësi i keni ato me Kosovamed, në të cilat komuna ka paguar qindra mira euro, e asnjëherë s’keni marrë përsipër që t’i raportoni këtij kuvendi kur ka votuar për kësi marrëveshje, ndërsa ne si grup fillimisht kërkoj që të raportohet për ato marrëveshje, e në vend që të raportohet ato marrëveshje ne vazhdojmë me Caritas-in e përfundojmë në përmbarime, ku bëhet drejtoria e 13 e komunës, prandaj kjo marrëveshje nga ana e LVV-se nuk duhet mu votu, pasi ne edhe do ta dërgojmë në MAPL, pasi edhe njëherë po them; kjo marrëveshje është detyrë e kryetarit, e jo për ne, ju faleminderit.

Xhevat Sallahu pasi përshëndeti të gjithë theksoi se kjo marrëveshje me Caritas janë bërë shumë shqetësuese.... (nuk dëgjohet) e kemi rastin e shkollës së fshatit tim ku një punëtor ka dal në pension, ndërsa tjetri që e kanë punësuar është me Caritas i punësuar, në Qendrën e mjekësisë familjare në Dardani, ma i mirë shërbimi kur ka qenë amf, pasi mjeku është me Caritas, tjetërsimi.... është shkelje e ligjit dhe ligjit të pagave (fjalimi i z.Sallahu është i pjesshëm pasi që nuk dëgjohet mirë).

Bashkim Haliti pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit theksoi se sa i përket marrëveshjes me Caritas-in veçse është bërë mirë që u evidentuan këto gabime teknike, që janë në këtë marrëveshje, mirëpo është edhe një lëshim aty ku thuhet se kontrata është dy vjeçare, ndërsa perioda e zbatimit prej 1 Janari 26 deri në Vitin 27, kjo e para tjetër mendoj që në terma financiar nuk është bash mirë e precizime, duhet me i pas disa të dhëna pak më shumë si dhe a kish pas mundësi edhe aneks 1, apo pjesën finale faleminderit.

Arian Imeri pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se sot kemi para vetës këtë marrëveshje në mes Caritas-it dhe komunës, e që kjo marrëveshje i dedikohet të rinjëve të komunës sonë, këtu po shohë që konkursi është edhe bashkëpunimi me biznese, pasi që me të vërtetë ju ndihmon të rinjëve që të tregojnë vetën para punëdhënësve, ku në kushte reale me siguri do të ishte e vështirë të arrihej, kjo do ta krijonte mundësi të jashtëzakonshme për të rinjtë në formimin e tyre në krijimin e vetëbesimit dhe besoj që iniciativa të tilla si kjo dhe tjera janë shumë të mirëseardhura e sidomos ku më shumë se gjysma e mjeteve mbulohet nga donatori, andaj nga këtu shfrytëzoj rastin që të falënderojmë

donatorin dhe Caritas-in Austrinë dhe mbi të gjitha që kanë zgjedh komunën tonë, pasi kanë mujt me dërgu diku tjetër këtë projekt, andaj ju ftoj të gjithëve që ta përkrahim këtë iniciativë.

Amir Rexhepi pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që mos të tingëllojë që ne jemi kundër, mirëpo dyshimet e mija janë që kjo marrëveshje po keqpërdoren, pasi që disa punëtor më herët ju ka skadu kontrata, e unë dyshoj që ata do të angazhohen të njëjtit, e kjo marrëveshje do të shërbej për t'i rahatu të njëjtit, edhe për Drejtorin e arsimit a do ta funksionalizoni me këtë marrëveshje çerdhen në Greme.

Balton Dërguti falënderoi për sygjerimet fillimisht ju them që projekt your job nuk ka të bëjë me këto çka thatë, kjo nuk do të ndodhë ju garantoj pasi që këtë projekt e zbatoj unë dhe ka kriteret të veçanta, ku një ndër to është 15-35 vjeçare, sa i përket asaj Bashkim do t'i rregullojmë edhe datat pasi e theksova që ka gabime teknike që do të përmirësohen, sa i përket aneksit atë e bëjmë nëse sot e merr dritën jeshile.

Kryesuesi e hodhi në votim këtë pikë dhe kaloi me 30 për, 00.

Kryesuesi e lexoi pikën e 5-të për emërimin e Nënkrjetarit të komunës për komunitete dhe propozimi është Jeton Emini, pasi propozime tjera nuk ka, e hodhi këtë propozim për votim, u miratua me 39 vota për, 00.

Kryesuesi theksoi që grupi punues e ka bërë Planin e punës për Vitin 2026 dhe pasi ska propozime tjera e hodhi për votim këtë pikë dhe e njëjta kaloi me 39 vota për, 00.

Kryesuesi e morri fjalën sa i përket pikës së 7-të për plotësim të Komitetit për politikë dhe financa, dhe theksoi që si jeni në dijeni MAPL-ja ka kthyer për shkak të kuotës ligjore, ku kërkon që të zëvendësohet një mashkull me një grua, por deri më tani nuk kemi ndonjë marrëveshje nga asnjë nga partitë politike për të zëvendësuar dhe për këtë çështje propozoj që të shtyhet për seancën tjetër.

Brahim Osmani, e para nuk është nga partitë politike, ju mund të thoni që ju pushteti s'keni marrëveshje, pasi ne si grup kemi plotësuar kuotën dhe atë kemi 50/50 dhe e dyta ju u dashtë në seancë me tregu që s'keni marrëveshje, ju veç i keni propozu emrat, nëse ska marrëveshje qysh kemi me funksionu, pasi na s'kemi nevojë mi hup 3 të KPF-së, pse ju s'keni marrëveshje.

Arian Imeri pasi përshëndeti të pranishmit tha se sa i përket numrave çështjet janë të rregulluara me ligj, prandaj ne si PDK në KPF kemi bërë 50/50, ndërsa rendi ju bjen LDK-së dhe ne mundemi me u tregu ma gjentlemen apo institucionalista për të lëshu vend, sa i përket Komitetit për komunitete ne kemi propozu 2 gra, në mënyrë që arrihet kuota dhe është mirë edhe partitë tjera që me pa në këtë formë dhe të reflektojnë.

Hatixhe Bungu Qerimi pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që sa i përket kësaj pike subjektet duhet të ndajnë edhe sa i përket ndarjes së fuqisë politike të subjekteve në kuvend, sa i përket kryesuesit në rastin konkret nuk mund të mirret përfaqësues politikë pasi kjo pozitë është përfaqësim i drejtpërdrejt ex officio dhe duke u nisur nga kjo përfaqësimi i AAK-së, në këtë komitet

është i mangët dhe s'kemi përfaqësues në këtë komitet, në rast se nuk përmirësohet, do të kërkojmë nga MAPL-ja interpretim ligjor.

Pasi s'pati tjerë në kuvend ne do të votojmë që kjo pikë të shtyhet dhe të kërkojmë nga Zyra ligjore interpretim, pasi u hodh për votim me 20 vota për, 7 kundër, u vendos që të shtyhet kjo dhe pika tjetër që është për Komitetin për komunitete.

Te pyetje dhe kërkesa: Brahim Osmani theksoi pyetje kam për Drejtorinë e bujqësisë pasi që edhe koka këtu në fund të Shtatorit 25, e ka nxjerrë një vendim për subvencionimin e litrës së qumështit, a ka mundësi me na tregu se sa fermerë kanë përfitu dhe nëse s'kanë përfitu pse, e keni ba këtë vendim kur s'keni pas mjete kur e keni nxjerrë një muaj para zgjedhjeve dhe pse tani pe anulon, tjetra është për Drejtorinë e shërbimeve publike për mirëmbajtjen e rrugës nga Talinovci i Muhaxherëve - Rahovicë që të intervenohet në atë rrugë pasi është në gjendje tepër të keqe dhe besoj që të intervenoj.

Amir Rexhepi unë kam pyetje për Drejtorin e shërbimeve publike ose Drejtorinë e bujqësisë t'ia përvjellë atij për shkak të reshjeve të shiut, ne se kemi pa në teren komisionin dhe e ftoj urgjentisht bashkë me Drejtorinë e bujqësisë që të dalin në teren dhe të marrin informatat në teren, sidomos në Fshatin Koshare, Tërrn ka patur përmytje dhe të intervenohet në ato pjesë, tjetra, i pash që faji ju ka gju komunës së Lipjanit, kinse s'është pastru Sitnica, duhet që të mos pasohet faji dhe të merret përsipër secili me punët e veta, ne i kemi kontakti institucionet dhe arsyetimi ka qenë banal që s'kemi kontratë, s'kemi marrëveshje, faleminderit.

Arbnor Murseli përshëndeti të pranishmit dhe mbasi drejtori koka këtu i Arsimit, desha ta pyes me çerdhen në Fshatin Greme çka ka ndodhë.

Sakip Haliti mbasi përshëndeti të pranishmit theksoi që Noli veçse e konsumoj pyetjen, pasi që vijë edhe unë nga ai lokalitet, ne siç e dimë funksionalizimi ka ndodhë në Shtatorë dhe në dhjetor është mbyll, pra kur ka fillu procesi në Janar ajo veç është mbyll, prindërit pyesin se çka do të ndodhë pasi që ata janë të detyruar t'i sistemojnë nëpër çerdhe private.

Doruntina Azizi pasi përshëndeti të gjithë theksoi sot dua të ndalem te një hallkë thelbësore e edukimit të hershëm të fëmijëve tanë, edukatoret e kopshteve, të cilat, shpesh pa zhurmë dhe pa vëmendje të mjaftueshme publike, mbajnë mbi supe përgjegjësi jashtëzakonisht të madhe.

Të gjithë e dimë nga përvoja personale se sot hapat e parë të edukimit dhe socializmit fëmijët tanë nuk i hedhin më te mësuesit e shkollës fillore, siç ka qenë dikur, por te edukatoret e kopshteve. Pikërisht aty formohen bazat e para të dijes, disiplinës, sjelljes dhe besimit.

Megjithatë, përkundër rëndësisë së jashtëzakonshme të punës së tyre, vlerësimi institucional për këta profesionistë mbetet i pamjaftueshëm.

Rasti konkret për të cilin po flas sot është Kopshti "Engjujt", i cili funksionon si partneritet publiko-privat ndërmjet Caritas Kosova dhe Komunës së Ferizajt. Stafi i këtij kopshti, prej vitesh, përballet me një situatë të vështirë dhe të përsëritur: pagat nuk u ekzekutohen nga muaji Gusht deri në muajin Mars, për t'u kompensuar më pas gjatë muajve të tjerë të vitit.

Edhe pse këto paga jepen më vonë, kjo nuk e zhbën pasigurinë që krijohet për punëtorët. Për shumë prej tyre, kjo punë është burimi i vetëm i të ardhurave, dhe vonesat e gjata ndikojnë drejtpërdrejt në procese jetësore themelore.

Duhet theksuar gjithashtu se këto edukatore paguhen me pagë minimale, rreth 369 euro neto, çka e bënë edhe më të ndjeshme çdo vonesë në pagesë.

Qëllimi i këtij diskutimi nuk është gjetja e fajtorëve, por identifikimi dhe ndërtimi i zgjidhjeve të qëndrueshme, për këtë arsye në emër të këtij institucioni dhe stafit të tij, kërkohet nga Kryesia e Komunës dhe drejtoritë përkatëse që, në bashkëpunim të plotë, të rishqyrtojnë me seriozitet marrëveshjen ekzistuese, planifikimin buxhetor dhe çdo aspekt tjetër të nevojshëm, me përgjegjësi dhe urgjencë institucionale.

Në këtë frymë, duke marrë parasysh se Kopshti "Engjujt" i plotëson kriteret profesionale, numrin e madh të kërkesave nga prindërit dhe faktin se në Komunën e Ferizajt aktualisht funksionon vetëm një çerdhe publike, propozoj që të shqyrtohet mundësia që ky institucion të kalojë në kompetenca të plota komunale dhe të shndërrohet në çerdhe publike.

Edhe pse kjo nuk varet plotësisht vetëm nga Komuna, jam e bindur se me bashkëpunim institucional dhe përpjekje të përbashkëta dhe të vazhdueshme të të gjithë akterëve relevant, mund të gjendet një zgjidhje adekuate për situatën e këtij kopshti në mënyrë që këta profesionistë të gëzojnë respektin institucional dhe dinjitetin që meritojnë.

Faleminderit.

Afrim Llabjani pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që ju e dini që në këtë kuvend kemi prur një propozim për një zgjidhje të vazhdueshme dhe të qëndrueshme për këtë punë, megjithatë ajo ska kaluar, por kemi bërë marrëveshje me Caritas Kosovën dhe ditët e ardhshme të javës janë ditët kur çerdhja do të funksionalizohet dhe prapë mendoj që të shiqohen mundësit që të bëhet një zgjidhje e qëndrueshme, është e pa mundur të bëhen çerdhe publike s'është që ne s'kemi lëvizur pasi është bërë një fizibilitet pasi që ka marrëveshje që këtu është votu, sa i përket çështjes së pagave ka vështirësi si e dini edhe ju, mirëpo asnjëherë nuk do t'i mbetet askujt borgj, por duhet patur parasysh edhe pagën e Janarit e kemi me ngritje, besoj që do të gjinden alternativa të qëndrueshme për këtë punë.

Burim Bajrami pasi përshëndeti të gjithë theksoi se tash e 13 muaj kemi bërë ndarjen e subvencioneve për lëmin e bujqësisë dhe t'i e grupi yt keni votu kundër këtij planifikimi, mirëpo tash t'paska hy një gajle se pse spo kryhen ato pagesa, po ta votoje sinqerisht, e kisha besu se pse e ki këtë shqetësim, mirëpo meqenëse se keni votu unë besoj që është e pa sinqertë kjo çështje, normalisht të gjithë ata që kanë apliku për litra në momentin që është votu buxheti dhe të alokohen mjetet dhe të ndahen në subvencione tek ne do t'i procedojmë për pagesë, Amir edhe t'i e edhe unë e dimë ku është problemi i anës tanë anej, e ku edhe Vojnovci ka patur probleme, mirëpo si e

dimë ku dega e lumit Sitnica ska ku të shkoj dhe kthehet kënde, masnej kem me ba presion që të intervenoj që të hapet ajo edhe t'i e dine dhe unë ku kemi ba presion për këtë pikë.

Brahim Osmani kemi votu kundër, pasi buxheti i komunës është rrit, ndërsa drejtorja ska pas rritje e para nëse ke pas plan ajo ka kalu edhe pse ne kemi votu kundër, ajo ka kalu pse ke marr vendim e tani e ke anul, e tash arsyetohesh që keni votu kundër.

Burim Bajrami pse bre Brah ke nevojë me thanë të pavërteta në Vitin 2025 në krahasim me 24 ka pas rritje prej 50 mij euro, vendimet i merr drejtorja përmes komisionit dhe në bazë të mundësive buxhetore por duke mos kalu shumen prej 1000 euro, nëse ki pakjartësi në proces ajo është tjetër.

Amir Rexhepi, Burim ne jemi shumë të sinqertë në kërkesa, ne kemi zona rurale dhe përditë na pyesin kur bahen pagesat, pasi në fushat ky vendim morri shumë nam edhe more vota shumë nëpër fshatra, e kur dolën votat e qytetit shkojshin tu ra, ndërsa në raste masnej thojshin as telefonin s'naj ka hap.

Burim Bajrami seriozisht Amir kur fol t'i kështu në raporte zyrtare dhe jo zyrtare seriozisht je për keqardhje kusht po të thotë ty që ne nuk pagujmë dame, çka është ky prezentim para kuvendarëve dhe t'i e di që nëse dikush e hap telefonin dhe del në teren jam unë Amir Rexhepi,

Xhevat Sallahu theksoi se sa i përket vërshimeve s'është vetëm si faktor shiu por edhe që janë mbyll procka (nuk dëgjohet)

Në të ndryshme si pikë e fundit.

Amir Rexhepi lidhur me burimin unë thash nuk tu drejtova ty po si drejtor ne kemi raporte po ashtu edhe raporte kolegiale (kryesuesi ia ndalon fjalën, pasi nuk je në temë në të ndryshme duhet të paraqisni kërkesa tjera të ndryshme dhe jo të kjarhtësoni raportet e juaja kolegiale apo jo kolegiale)

Meqenëse ska tjerë të interesuar për diskutim ju njoftoj që i mbylлим punimet e kësaj mbledhje.

Procesmbajtësi



Leutrim Mahmuti



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhavit Zariqi